



KOMENTE NGA ANËTARË TË KËSHILLIT TË INVESTIMEVE 2018 - 2019

Përgatitur nga:
**Sekretariati i Këshillit
të Investimeve**

Këshilli i Investimeve mbështetet nga Ministria e Financës dhe Ekonomisë, BERZH
dhe Sekretariati Shtetëror Zvicerian për Çështje Ekonomike (SECO)

Anëtarë të intervistuar

SEKTORI PUBLIK



Z. Eduard Shalsi,
Ministër Shteti
për Mbrojtjen e
Sipërmarrjes



Znj. Majlinda
Gjata Demko,
Këshilltare,
Ministria e
Financës dhe
Ekonomisë



Znj. Natasha
Ahmetaj,
Zv. Guvernatore,
Banka e
Shqipërisë



Znj. Mileva
Meksi,
Drejtoreshë e
Departamentit
të Investimeve,
AIDA

SEKTORI PRIVAT



Z. Edmond
Spahiu,
Drejtor
Ekzekutiv,
AlbStar sh.p.k.



Z. Tom Kristian
Larsen,
President,
Shoqata e
Investitorëve
të Huaj në
Shqipëri (FIAA)



Znj. Ines
Muçostepa,
Kryetare,
Bashkimi i
Dhomave
të Industrisë
dhe Tregtisë
(UCCIAL)



Znj. Mira
Pogaçi,
Drejtoreshë
Ekzekutive,
Bashkimi Tregtar
i Shqipërisë
(BTSH)



Z. Seyhan
Pencabligil,
Drejtor
Ekzekutiv,
Banka
Kombëtare
Tregtare (BKT)

PARTNERËT PËR ZHVILLIM



Znj. Laura Qorlaze,
Përfaqësuese,
Korporata
Ndërkombëtare
Financiare (IFC)



Znj. Hilda
Shijaku,
Ekonomiste,
Banka Botërore



Znj. Ledia Muço,
Këshilltare për Çështjet
Ekonomike dhe Tregtisë,
Delegacioni i Bashkimit
Evropian

PËRMBAJTJA

Konteksti	4
Mesazhet kryesore	5
I. Formati dhe Organizimi i KI	6
II. Cilësia dhe niveli i përfaqësimit të partnerëve	8
III. Vizibiliteti i KI	8
IV. Influenca në Klimën e Investimeve	9
V. Eksperiencia personale dhe profesionale me KI	10
VI. Qëndrueshmëria e platformës së KI	10
VII. Vijueshmëria e bashkëpunimit tuaj me KI/anëtarët e KI	11



KONTEKSTI

Këshilli i Investimeve (KI), luan një rol të rëndësishëm në debatin kombëtar mbi çështje të mprehta të klimës së investimeve në vend. Fokusi kryesor i punës së tij lidhet me mjedisin institucional, rregullator dhe politik në të cilin kompanitë investojnë, krijojnë vende pune apo zgjerohen, por edhe në ndërveprimin me institucionet shtetërore dhe aktorë të tjerë privatë që influencojnë performancën ekonomike të vendit.

Në maj të vitit 2019, Qeveria Shqiptare mbi bazën e sugjerimeve të përfaqësuesve nga biznesi, me VKM nr.335 dt. 22/05/2019, rriti me dy anëtarë nivelin e pjesëmarrjes së përfaqësuesve nga shoqatat e biznesit në Këshillin e Investimeve. Theksojmë se përfaqësuesit nga komuniteti i biznesit, kanë kontribuar në mënyrë aktive si në prioritizimin e problematikave kryesore dhe hartimin e axhendës së KI, ashtu edhe në konsultimet, anketat e përvitshme si edhe në dhënien e rekomandimeve konkrete për problematika të klimës së investimeve.

Me synim përmirësimin e vazhdueshëm të punës së KI, Sekretariati përgatit çdo vit një raport, i cili evidenton komentet e anëtarëve mbi formatin dhe përbërjen e KI, cilësinë e punës, eksperiencën personale si anëtarë të KI, vizibilitetin dhe influencën në dialogun mbi klimën e investimeve në vend si edhe në sugjerime për përmirësime të mëtejshme të punës. Për herë të parë, gjatë periudhës nëntor - dhjetor 2019, përveç anëtarëve nga komuniteti i biznesit (5), u intervistuan edhe përfaqësues të institucioneve qeveritare (4) dhe anëtarë përfaqësues të partnerëve për zhvillim (3).

Struktura e pyetjeve është e përafërt me vitet e mëparshme ndërsa procesi i anketimit u krye nga eksperti i monitorimit, që iu bashkua Sekretariatit në korrik 2019. Disa nga pyetjet u strukturuan për t'iu dhënë mundësinë të intervistuarve të përzgjedhin mes disa opsioneve, ose bazuar në pikësime. Vlerësojmë së tepërmi angazhimin e anëtarëve për të ofruar komente narrative mbi pyetjet e adresuara në lidhje me punën tonë.

Aktualisht, KI mbetet organi këshillimor dhe platforma e dialogut privat-publik më e strukturuar për sa i përket përcjelljes së mesazheve në lidhje me problematika të klimës së investimeve.

MESAZHET KRYESORE

Pikat e forta të Këshillit të Investimeve në këndvështrimin e anëtarëve të tij:

- ▶ Aktualisht, KI mbetet organi këshillimor dhe platforma e dialogut privat-publik më e strukturuar për sa i përket përcjelljes së mesazheve në lidhje me problematika të klimës së investimeve. Matja e impaktit mbetet e vështirë por përcjellja e mesazheve është shumë e rëndësishme.
- ▶ Pothuajse të gjithë anëtarët shprehën dëshirën për të bashkëpunuar e kontribuar me platformën e KI në të ardhmen, pasi vlerësohet angazhimi përmes votimit të temave për përgatjen e axhendës, analizave profesionale dhe rekomandimeve të dhëna mbi tematika specifike si dhe transparencës përmes publikimit të të gjithë materialeve.
- ▶ Kjo platformë duhet të jetë e qëndrueshme dhe funksionale deri sa instrumenti i komunikimit dhe dialogut publik-privat të bëhet i qëndrueshëm.
- ▶ Vlerësohet si i shumë i rëndësishëm drejtimi i mbledhjeve nga vetë Ministri dhe që BERZH është një faktor i rëndësishëm suporti.

Sugjerime për përmirësim:

- ▶ Institucionet qeveritare duhet të përmirësojnë angazhimin e tyre përmes një reagimi më të shpejtë mbi implementimin e rekomandimeve, duke patur parasysh që janë edhe anëtarë të KI.
- ▶ Drejtuesit e dhomave dhe shoqatave të biznesit të përcjellin komente me shkrim dhe në mënyrë të strukturuar përpara mbledhjeve duke reflektuar problematikat konkrete të bizneseve të tyre.
- ▶ Numri i mbledhjeve mundësisht të rishikohet në ulje, ndërkohë të konsiderohet hapësirë në axhendën e vitit pasardhës, që një mbledhje të trajtojë një tematike të posaçme sipas situatës specifike të atij viti. Ky sugjerim vjen nga përfaqësues të biznesit.
- ▶ Herë pas here të sillen në vëmendje të anëtarëve të KI rekomandimet e papërmbyshura nga temat e trajtuara në mbledhjet e mëparshme, ku Ministri i Financave dhe Ekonomisë të kërkojë raportim nga institucionet publike përgjegjëse lidhur me arsyen e mospërmbyshjes. Ky rekomandim vjen nga tre anëtarë, dy nga institucionet qeveritare dhe një nga partnerët për zhvillim.
- ▶ Mundësisht të konsiderohet përfshirja si anëtarë i Shoqatës së Bashkive, Shoqatës Shqiptare të Bankave dhe Biznese të Vogla dhe të Mesme që operojnë në zonat rurale. (Sugjerimi u përcoll nga dy anëtarë të komunitetit të biznesit dhe një nga partnerët për zhvillim).
- ▶ Materialet të jenë më koncize dhe të përmbledhura, formulimi i rekomandimeve të jetë më specifik, p.sh. të përqëndrohet fokusi në 2-3 rekomandime për mbledhje.
- ▶ Rritje e vizibilitetit të KI përmes rrjeteve sociale e medias vizive, por edhe përmes zhvillimit të mbledhjeve pranë ambjenteve të bizneseve që kanë të bëjnë në mënyrë të drejtpërdrejtë me temën që trajtohet, mundësisht nëpër rrethe. Kjo do rriste edhe besimin tek kjo platformë.


I. FORMATI DHE ORGANIZIMI I KI

Eksperiencia dhe sugjerimet e përfaqësuesve të biznesit janë sjellë në mënyrë të detajuar më poshtë sipas komponentëve kryesore:


P. Si e vlerësoni formatin dhe organizimin e mbledhjeve të Këshillit të Investimeve?

- Formatin e KI është më i miri dhe temat që trajtohen janë mjaft të goditura. Vlerësohet shumë puna e bërë nga Sekretariati për organizimin e mbledhjeve të KI-së, përgatitjen e notave teknike dhe materialeve;
- Anëtarësia është gjithëpërfshirëse. Metodologjia dhe rekomandimet janë të shkëlqyera dhe të mirë realizuara. Tematikat kanë qenë me spektër mjaft të gjerë duke mbuluar disa industri dhe institucione;
- Përsa i përket anëtarësisë, vlerësohet rritja e numrit të anëtarëve të përhershëm nga biznesi;
- Metodologjia e përzgjedhjes së tematikave përmes votimit është shumë e mirë dhe e vlerësuar.

Të pyetur për vlerësimin e formatit dhe organizimit të KI përmes pikësimit të katër faktorëve kryesorë:



Sikurse tregohet në grafikun e mëposhtëm, mes mundësive për përzgjedhje: Duhet përmirësuar; Mirë; Kënaqshëm; Shumë mirë; Shkëlqyeshëm, 11 nga anëtarët vlerësuan kryesisht me "shumë mirë" dhe "shkëlqyeshëm" katër faktorët e mësipërm (një nga anëtarët nuk komentoi mbi këtë pikë):




Përqindja shpreh numrin e anëtarëve të cilët dhanë vlerësimin "kënaqshëm", "shumë mirë", "shkëlqyeshëm" për secilin faktor. Për shembull, 73% e të intervistuarve mendojnë se anëtarësia e KI është shumë e mirë.

P. Cilat do t'i konsideroni si pika të forta të KI?

- Analizë dhe punë studimore shumë e mirë për përgatitjen e materialeve;
- Tematikat e trajtuara dhe metodologjia e votimit të temave është shumë e vlerësuar nga anëtarët e KI;
- Gjithëpërfshirja, angazhimi dhe tërheqja e vëmendjes së përfaqësuesve kryesorë të qeverisë dhe bizneseve i jep shumë vlerë formatit;
- Vëmendja e aktorëve kryesorë të qeverisë përmes pranisë së përhershme të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë;
- Rekomandimet shumë konkrete dhe cilësore si dhe puna sistematike në ndjekjen e tyre;
- Puna aktive e Sekretariatit dhe kualifikimi i stafit të tij, është një nga pikat më të forta të KI;
- Metodologjia e punës, ndjekja e çështjeve dhe insistimi në realizimin e objektivit;
- Nxiti qeverinë të prioritetizojë veprimet e saj dhe në këtë mënyrë të realizojë premtimet që jep;
- Presenca e BERZH është një faktor i rëndësishëm që rrit reputacionin;
- Transparenca përmes publikimit të të gjithë materialeve të prodhuara.

Pikat e forta të KI



II. CILËSIA DHE NIVELI I PËRFAQËSIMIT TË PARTNERËVE

(Shoqata biznesi, biznese, institucione shtetërore, partnerë zhvillimi dhe niveli i tyre i përfaqësimit)

P. Pas ndryshimeve të fundit të bëra nga KI me rritjen e numrit të pjesëtarëve të biznesit me 13%, ky komunitet a është realisht i përfaqësuar në KI (në nivel sektori, madhësie, shtrirje gjeografike, barazie gjinore, etj.)? A kontribuojnë shoqatat e biznesit në dialog në mënyrë gjithëpërfshirëse mbi problematikat më të rëndësishme të anëtarëve të tyre?

- KI ka sjellë risinë e anëtarëve me mandat të përhershëm nga biznesi dhe rritjen e numrit të tyre gjatë vitit të fundit duke forcuar zërin e komunitetit të biznesit. Megjithatë, sugjerohet që pjesëmarrës të jenë biznese të ftuar sipas sektorit dhe temës specifike që diskutohet në çdo mbledhje pa qenë nevoja të emërohen me mandat të përhershëm.
- Institucionet qeveritare duhet të përmirësojnë angazhimin e tyre përmes një reagimi më të shpejtë mbi implementimin e rekomandimeve, duke patur parasysh që janë edhe anëtarë të KI.
- Institucionet publike duhet të raportojnë në lidhje me përmbushjen e rekomandimeve të propozuara.
- Zëri i anëtarëve të dhomave dhe shoqatave të biznesit është i limituar pasi drejtuesit përkatës përcjellin kryesisht mendimet e tyre vetjake.

III. VIZIBILITETI I KI

P. A mendoni se Këshilli i Investimeve është i njohur mjaftueshëm nga komuniteti i biznesit?

- KI ka krijuar tashmë profilin e tij në ambjentin ku operon dhe më e rëndësishmja ka influencë për të mbledhur në konsultime e tryeza në një kohë të shkurtër anëtarët dhe pjesëmarrës të rëndësishëm.
- KI është i njohur nga institucionet e interesuara. Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme, pjesëmarrja e studentëve në aktivitetin e Sekretariatit, bashkëpunimi me shoqërinë civile si Risi Albania e të tjera institucione, janë të gjitha shumë të vlefshme për vizibilitetin.
- Për rritjen e vizibilitetit, sugjerohet që mbledhjet të mund të organizoheshin edhe në ambjentet e një biznesi përfaqësues për temën specifike që diskutohet në mbledhje, në mënyrë që bizneset të angazhohen më shumë në rritjen e vizibilitetit të KI.
- Shoqatat e biznesit dhe dhomat e tregtisë anëtare të KI mund të luajnë një rol më aktiv në rritjen e vizibilitetit tek anëtarët e tyre.

IV. INFLUENCA NË KLIMËN E INVESTIMEVE

P. A mendoni se puna e Këshillit të Investimeve bën dallimin nga formate të ngjashme të dialogut publik – privat? A ka ndikuar KI në përmirësimin e dialogut për klimën e investimeve në Shqipëri?

- KI është Këshilli më i strukturuar për sa i përket dialogut publik privat. Nuk ka tjetër format kaq të strukturuar;
- Ka ndikuar në rritjen e transparencës dhe komunikimin konsultativ;
- Në strukturat e tjera të dialogut publik-privat çështjet trajtohen duke u kufizuar në specifikën e caktuar, ndërsa në KI merr një shtrirje më makro;
- KI bën dallimin si nga përbërja ashtu dhe nga ana teknike;
- Ka ndikuar pozitivisht, por do të duhej që organet shtetërore të ndiqnin me më shumë impajm realizimin e rekomandimeve për të arritur rezultate më të mira;
- Po, është platforma më e sukseshme për përcjelljen e mesazheve, ndërkohë ndikimi në klimën e biznesit varet nga qeveria;
- Herë pas here, Sekretariati duhet të përfshijë në axhendën e mbledhjes rekomandimet e papërbushura nga tematika të trajtuara në mbledhjet e mëparshme. Ministri i Financave dhe Ekonomisë të kërkojë raportim nga institucionet publike përgjegjëse lidhur me arsyen e mospërbushjes.

P. Sipas mendimit tuaj, cilat janë mënyrat më të mira për të matur impaktin e punës së KI ndër vite dhe kontributin në përmirësimin e klimës së investimeve?

- Mënyra më e mirë për të matur impaktin është përqindja e rekomandimeve të implementuara, por duke qenë organ këshillimor kjo përqindje varet drejtpërsëdrejti nga vullneti i institucioneve qeveritare;
- Funksionimi sa më i mirë i KI sjell edhe rritjen e ndërgjegjësimit të organeve publike për të dëgjuar më shumë mendimet e biznesit;
- Përcjellja e mesazheve është shumë e rëndësishme;
- Është e vështirë të matet impakti.

V. EKSPERIENCA PERSONALE DHE PROFESIONALE ME KI

P. Gjatë eksperiencës tuaj me Këshillin e Investimeve, çfarë konsideroni si përfitimin tuaj më të madh nga ky anëtarësim?

- Rëndësia e kësaj platforme është harmonizimi i shumë faktorëve dhe koordinimi perfekt mes palëve;
- Njohje të problematikave të ofertës dhe kërkesës në ekonominë reale dhe cilësisë së transmetimit dhe komunikimit të këtij sektori me atë financiar;
- Analizat sektoriale kanë mbushur një boshllëk informacioni që anëtarët kanë patur;
- Është një mundësi shumë e mirë për të dëgjuar nga informacionet e ndara dhe për të përcjellë mesazhet tona.

P. Cili mendoni se ka qënë kontributi juaj kryesor në punën e KI?

- Rekomandimet e sjella në mbledhje;
- Përcjellja e shqetësimeve të anëtarëve të institucionit që përfaqësoj;
- Ekspertiza për çështje të kredisë dhe infrastrukturës bankare.

VI. QËNDRUESHMËRIA E PLATFORMËS SË KI

P. A e shikoni Këshillin e Investimeve si një platformë afatgjatë dhe me interes për biznesin?

- Kjo platformë duhet të jetë patjetër funksionale deri sa instrumenti i komunikimit publik privat të bëhet i qëndrueshëm dhe të funksionojë normalisht. Kjo nuk përjashton edhe forcimin e rolit të dhomave të tregtisë lidhur me përcjelljen dhe zgjidhjen e shqetësimeve të biznesit;
- KI mund të përshtatet për të kontribuar në faza të ndryshme të përmirësimit të klimës së investimeve, duke luajtur rolin e katalizatorit.

VII. VIJUESHMËRIA E BASHKËPUNIMIT TUAJ ME KI/ANËTARËT E KI

P. Si e shikoni në vazhdim bashkëpunimin tuaj me Sekretariatit dhe Këshillin e Investimeve? A do ishit të gatshëm të merrnit iniciativën që të orientoni Sekretariatit e KI për të ngritur një temë specifike për diskutim në KI, të përfshinjt Sekretariatit e KI në mbledhje si p.sh. pjesëmarrës në mbledhje bordi/pjesë e komiteteve/aktivitete me fokus klimën e investimeve të organizuara nga ju, të ndani me Sekretariatit materiale analitike apo dokumentuese të problematikave të hasura nga ju, për shqyrtim në KI apo ndjekje të mëtejshme?

- Patjetër që shprehim gatishmëri dhe sugjerojmë që të kërkohe më shumë informacion me shkrim nga anëtarët përpara mbledhjeve;
- Po dhe kemi treguar angazhimin tonë me propozimet tona mbi temat e konsideruara të rëndësishme;
- Kemi një raport të vazhdueshëm institucional me KI dhe e konsiderojmë aktor të rëndësishëm në aktivitetet që organizojmë.





Albania
Investment
Council

Improving Investment Climate



Botuar nga: Sekretariati i Këshillit të Investimeve (KI) , Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri / T. +355 692631300 / info@investment.com.al

 Albania Investment Council  ALInvestCouncil  Albania Investment Council